



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	25.07.2019
REFERENC-Ë:	350 / 19
PËR/ZA/TO:	AK – “Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit” OE – “Albi Company”shpk
NGA/OD/FROM:	Nuhi Paçarizi Kryetar i Panelit Shqyrtues-OSHP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	N J O F T I M

Operatori Ekonomik: OE - “Albi Company”shpk si palë e pa kënaqur më datën: 27.06.2019, ka parashtruar ankesë me nr. 350 / 19, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit, lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull: Ri – Tender “Masat preventive-Intervenime Emergjente në Objekte Shtëpi në Prizren” me nr. të Prokurimit : 207-19-1586-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit” duke pretenduar se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së,

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimi të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 10.06.2019, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve ankimore të OE – “Albi Company”shpk

Eksperti i OSHP-së më datën: 08.07.2019, ka dorëzuar raportin me të gjitha sqarimet dhe rekomandimin e tij lidhur me ankesën e lartpërmendur, me ç’rast ka vlerësuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës OE – “Albi Company”shpk është e bazuara dhe rrjedhimisht ka rekomanduar panelin shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e OE- ankues dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **RI - VLERSIM**

Me datën: 08.07.2019, Autoriteti Kontraktues: AK - “Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit” si dhe parashtruesi i ankesës: OE- “Albi Company”shpk e kanë pranuar raportin e ekspertizës, lidhur me

aktivitetin e prokurimit: Ri – Tender "Masat preventive-Intervenime Emergjente në Objekte Shtëpi në Prizren" me nr. të Prokurimit : 207-19-1586-5-2-1

Autoriteti kontraktues AK- "Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit" përmes parashtresës së datës: 16.07.2019, pas pranimit të raportit të ekspertit shqyrtues ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 08.07.2019 që ky aktivitet i prokurimit të rivlerësohet sipas **nenit 59 të LPP-së**

Operatori ekonomik: OE : "Albi Company" shpk përmes parashtresës së datës: 11.07.2019 ka njoftuar OSHP-në , se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 08.07.2019

Paneli Shqyrtues, njofton OE ankues dhe Autoritetin Kontraktues, se konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues: AK- "Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit" lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ri – Tender "Masat preventive-Intervenime Emergjente në Objekte Shtëpi në Prizren" me nr. të Prokurimit : 207-19-1586-5-2-1 të **RI-VLERESOHET** ky aktivitet i prokurimit sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues, zbatimin e rekomandimit të ekspertit shqyrtues, dhe në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues OE – "Albi Company" shpk konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përbërja e Panelit Shqyrtues:

z. **Nuhi Paçarizi** _____ Kryetari i Panelit Shqyrtues,

z. **Blerim Dina** _____ Referues,

z. **Goran Milenković** _____ Anëtar.